

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Have Haliti dhe Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Përparim Zeka, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarëve: N.D.për shkak të veprës penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 dhe 2 të KPRK-së dhe të akuzuarve, I.D. dhe Y.H., për shkak të veprës penale, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e të akuzuarit N.D.dhe mbrojtësit tij av. Rr.L. , të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.14/2018, të datës 22.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, me datë 26.04.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. Refuzohen si të pa bazuara, ankesa e të akuzuarit N.D.dhe e mbrojtësit të tij, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore DKR në Gjilan, PKR.nr.14/2018, i datës 22.01.2018, vërtetohet.

II. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore-DKR në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.14/2018, të datës 22.01.2018, të akuzuarit, N.D., I.D. dhe Y.H., i ka shpallur fajtorë, të akuzuarin N.D., për shkak të veprës penale Blerja, posedim, shpërndarje dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 dhe 2 të KPRK-së. Të akuzuarit, I.D.dhe Y.H., për shkak të veprës penale, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par. 1 i KPRK-së, të akuzuarin, N.D.e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, dhe dënim me gjobë në shumën prej 300( treqind) €, të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të akuzuarit N.D.në dënimin e shqiptuar me burgim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.12.2017 deri më datën 09.01.2018. Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do tia zëvendësoj në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) €, do ti llogaritet 1 ditë burgu. Të akuzuarit,

I.D.dhe Y.H., i ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve dhe dënim me gjobë në shumën prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të akuzuarit, brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryejnë vepra tjera penale.

Konform nenit 62 të akuzuarëve, iu është shqiptuar edhe dënim plotësues, ashtu që të akuzuarit N.D.i janë konfiskuar substancat narkotike të llojit “Marihuanë”, dhe atë 11 paketime të ndara të mbështjellura me qese me peshë prej 53.2 gr., dhe qese të mbështjella plasmani me peshë prej 115.1 gr. marihuanë. Të akuzuarit I.D., i është konfiskuar 1 (një) paketim i mbështjellur me qese, në peshë prej 7.1 gr. dhe një paketim tjetër po ashtu prej 0.7 gr. e llojit “Marihuanë”.

Të akuzuarit, janë obliguar që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej 20(njêzet) €, në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

I akuzuari N.D.dhe mbrojtësi i tij av. Rr.L. , për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshohet të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më të butë apo ti mundësohet zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë ose punë në dobi të përgjithshme shoqërore.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.133/18, të datës 29.03.2018, ka propozuar që të refuzohen si të pa bazuara, ankesa e të akuzuarit N.D.dhe av. Rr.L. , ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par. 1 dhe 4 të KPPK-së, ka mbajtur seancën e kolegjit, në séance nuk kanë prezantuar asnjë nga palët, të gjitha palët janë ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e kolegjit dhe në mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar, andaj kolegji mbajti seancën në mungesë të palëve.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, të mbrojtësve të akuzuarve, aktgjykimin e ankimuar, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit N.D.dhe e mbrojtësit të tij av. Rr.L. , janë të pa bazuara.

Gjykata e Apelit duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Por ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi nga kjo gjykatë, me ankesë nuk mund të kontestohet aktgjykimi konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, sepse i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën e cila i vihet në barrë, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, kryetari i trupi gjyqësor është pajtuar me një pohim të

tillë, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoj vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore, përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë pretendon, se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, duke theksuar se i akuzuari jeton në kushte të vështira material, se qëllimi i shitjes së substancës narkotike ishte vetëm për të siguruar kafshatën e bukës për familjen e ngushtë të tij, i akuzuari është penduar sinqerisht dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale, e ka nënën të moshuar dhe të sëmur dhe nuk ka se kush të kujdeset për të, bazuar në të gjitha këto rrethana, kosnideron se më një dënim më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Kurse i akuzuari në ankesë, pretendon se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese gjatë marrjes së dënimit, mirëpo është dashur që ta ketë parasysh rrethanën lehtësuese se është mbajtës i familjes, me shkuarjen e tij në vuajtjen e dënimit do ta humb edhe punën që kryen si ndihmës elektircistë, se dënim që është i rëndë, nuk përkon me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, ka propozua që ti shqiptohet një dënim më të butë apo ti mundësohet zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë ose punë në dobi të përgjithshme shoqërore.

Duke pasur parasysh rrethanat në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit, si dhe duke i vlerësuar pretendimet ankimore, kjo gjykatë gjen se janë të pa bazuara pretendimet e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese, kështu që si rrethana lehtësuese, ka marrë për bazë pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, gjendjen e vështirë ekonomike të tij.

Kjo gjykatë gjenë se, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh, pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, gjendjen e vështirë ekonomike, duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana lehtësuese i ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit dhe i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj, kurse mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari në ankesë nuk kanë paraqitur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, e që nuk e ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit, kjo gjykatë i aprovon rrethanat lehtësuese që ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit, andaj gjënë se, dënimi i shqiptuar të akuzuarit, është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK-së.

Nga çka u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK- së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.138/18 me 26.04.2018

Procesmbajtësi,

Përparim Zeka

Anëtarët e kolegjit,

Have Halitit, \_\_\_\_\_

Fillim Skoro, \_\_\_\_\_

Kryetarja e kolegjit,

Tonka Berishaj